

# MANUAL PËR USHTRIMIN E TË DREJTËS SË E-PETICIONIT DHE E-INICIATIVËS DREJTUAR KËSHILLAVE BASHKIAKË

Janar 2023



# PËRMBAJTJA

## 1. Historiku i peticioneve dhe iniciativave qytetare

## 2. Peticionet dhe iniciativat qytetare sipas rregulloreve të Këshillave Bashkiake

### 3. E- Peticioni

- 3.1 Cfarë është e- peticioni?
- 3.2 Kush ka të drejtë t'i paraqesë Këshllit Bashkiak një peticion?
- 3.3 Kush e përfaqëson peticionin?
- 3.4 Cfarë duhet të përmbajë një peticion elektronik?
- 3.5 A mund të bashkëlidhen dokumenta të tjerë shoqërues një peticioni elektronik?
- 3.6 A ndikon numri i nënshkrimeve të mbledhura në vendimmarrjen për një peticion?
- 3.7 Cfarë vendimi mund të marrë Këshilli Bashkiak për një peticion elektronik?
- 3.8 Raste studimore e-peticioni


### 4. E – Iniciativa Qytetare

- 4.1 Cfarë është e- iniciativa qytetare?
- 4.2 Kush ka të drejtë t'i paraqesë Këshllit Bashkiak një iniciativë qytetare?
- 4.3 Kush e përfaqëson iniciativën?
- 4.4 Cfarë duhet të përmbajë një iniciativë elektronike?
- 4.5 A mund të bashkëlidhen dokumenta të tjerë shoqërues një iniciative elektronike?
- 4.6 Cfarë vendimi mund të marrë Këshilli Bashkiak për një iniciativë elektronike?
- 4.7 Si mund të nisësh një peticion ose iniciative qytetare elektronike nëpërmjet platformës [www.perqytetin.com](http://www.perqytetin.com)?
- 4.8 Si realizohet mbledhja e nënshkrimeve elektronike nëpërmjet platformës [www.perqytetin.com](http://www.perqytetin.com)?
- 4.9 Raste studimore e-iniciativa

## 1. HISTORIKU I PETICIONEVE DHE INICIATIVAVE QYTETARE

Peticionet dhe iniciativat qytetare janë kërkesa ose ankesa që i drejtohen një zyrtari apo enti publik nëpërmjet nënshkrimit nga qytetarë të shumtë. Peticionet e para të dokumentuara u bënë nga skllëvërit që ndërtonin piramida në Egjiptin e Lashtë, të cilët kërkuan kushte më të mira pune.

Në Kinën Perandorake para-moderne, petitionet dërgoheshin gjithmonë në Zyrën e Perandorit ku sekretarët e gjykatës i lexonin petitionet me zë të lartë. Peticionet mund të dërgoheshin nga kushdo, nga një dijetar tek një fermer i zakonshëm. Peticionet i lexoheshin perandorit për të fajësuar zyrtarët lokalë të dyshimtë për korrupsion në detyrën që ushtronin.



Shfaqja e petitionit gjatë mbretërimit të Eduardit I të Anglisë (1272-1307) kontribuoi në fillimet e pushtetit legjislativ për Parlamentin e Anglisë. Koncepti aktual i petitionit i korrespondon asaj ç'ka është parashikuar shekuj më parë në Magna Carta, një prej dokumenteve të parë ligjor hartuar në Mbretërinë e Anglisë në vitin 1215. Në Magna Carta (përkthimi në anglishten moderne), thuhet: "Nëse ne, kryegjyqtari ynë, nëpunësit tanë, ose ndonjë prej shërbëtorëve tanë kryen ndonjë shkelje kundrejt një

personi ose shkel ndonjë prej neneve të qetësisë dhe sigurisë, dhe shkelja është bërë në dijeni të katër prej 25 baronëve, ata duhet të vinë tek ne – ose në mungesë tonë te kryegjyqtari – të deklarojnë dhe të kërkojnë rivendosje të menjëhershme të të drejtës." Me fjalë të tjera, edhe pse pushteti u ishte dhënë 25 baronëve të zgjedhur nga Mbreti, këta e kanë ende autoritetin të ngrenë petition ndaj Mbretërisë, nëse ndiejnë se janë shkakuar padrejtësi.

Në SHBA, e drejta e peticionit përbën një prej pesë lirive themelore të parashikuara në aktin Bill of Rights të Kushtetutës së vitit (Amendamenti I). Në vitin 1963 është përfshirë në nenet e Rregullores së Parlamentit Europian dhe për të ardhur më pas më 12 prill 1989 në marrëveshjen ndërinstitucionale midis Parlamentit Europian, Këshillit dhe Komisionit Europian, ku u konfirmua kjo e drejtë dhe u ofrua nja garanci më shumë në lidhje me ndjekjen e peticioneve në BE. Në vitin 1992, Marrëveshja e Maastricht-it përfshiu të drejtën e peticionit midis shumë të drejtave të tjera njohur qytetarëve të BE.



Organizatat joqeveritare si Amnesty International shpesh përdorin peticione në përpjekje për të ushtruar autoritet moral në mbështetje të kauzave të ndryshme.


Sot, peticionet në Britani dhe SHBA paraqiten shpesh përmes faqeve së internetit të peticioneve të Parlamentit të Mbretërisë së Bashkuar dhe institucionit të Presidentit në SHBA, ku qytetarëve u jepet mundësia të nënshkruajnë për kauza komunitare.

Peticionet elektronike janë një formë e re e një peticioni që u bë e zakonshme në shekullin e 21-të. Change.org u themelua në vitin 2007 dhe u bë platforma më e popullarizuar e peticioneve online në botë me rreth 50 milionë përdorues të regjistruar.

Aktualisht në Republikën e Shqipërisë qytetarët kanë mundësi ligjore dhe institucionale për t'ju drejtuar Kuvendit të RSH dhe Bashkive me peticione dhe iniciativa ligjore qytetare duke përdorur edhe mjetet e reja të nënshkrimit elektronik.

## 2. PETICIONET DHE INICIATIVAT QYTETARE SIPAS RREGULLOREVE TË KËSHILLAVE BASHKIAKE

Në zbatim të nenit 19 dhe 20 të ligjit 139/2015 për vetqeverisjen vendore, Këshillat Bashkiake kanë miratuar rregullore të posaçme për mundësimin e iniciativave dhe peticioneve vendore ndaj qytetarëve të tyre. Sipas kësaj rregulloreje peticioni është një kërkesë drejtuar Këshillit Bashkiak apo Komisionit të Përhershëm të Këshillit, për ta nxitur të ndër marrë apo të mos ndër marrë një veprim apo marrë vendim me interes kolektiv publik, i bërë me shkrim dhe i shoqëruar me nënshkrime nga një grup qytetarësh ose banorësh, grup organizatash apo grupe interesi, dhe që i adresohen për çështje në kompetencë ligjore të Këshillit, apo për një çështje për të cilën Këshill ka mundësi të influencojë apo llojë. Objektivat që parashikon rregullorja e peticioneve dhe iniciativave për rolin e tyre janë:



- Forcimi i demokracisë vendore
- Angazhimi i qytetarëve në çështjet e politikave publike
- Promovimi i pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrjen bashkiake
- Ngushtimi i distancës midis të përfaqësuarve dhe përfaqësuesve të tyre,
- Promovimi i transparencës në vendimmarrjen e Këshillit

Peticionet mund ti drejtohen organeve kolegjinale të ngritura në kuptim të ligjit sic janë:

- Këshillit Bashkiak
- Kryesisë së Fshatit
- Këshillit Komunitar në Lagje


**Peticionet elektronike** zhvillohen dhe dorëzohen përmes faqes së internetit të Bashkisë, dhe respektojnë të njëjtat kërkesa dhe procedura si peticionet me letër.

- Parashtruesit e peticionit dorëzojnë me shkrim në zyrën e protokollit të Bashkisë kërkesën për krijimin e peticionit elektronik, sëbashku me të dhënat e peticionit.
- Për të nënshkruar peticionin elektronik mbështetësit fusin në aplikacion e peticionit të dhënat si emrin, adresën postare apo kodin postar dhe një adresë të vlefshme email-i.
- Nëshkruesi do të marrë një email në adresën e tij/saj me anë të së cilës do të konfirmohet nëse adresa e email-it është e vlefshme.
- Një peticion elektronik nuk mund të zhvillohen njëkohësisht me në peticionin me shkresë, ndërkohë që ata kanë të njëjtën kërkesë dhe të njëjtët organizatorë.

Ndërkohë sipas rregullores Bashkitë duhet të publikojnë dhe përditësojnë regjistrin e peticioneve dhe iniciativave në faqen e tyre si shëmbulli më poshtë për të gjurmuar ecurinë e peticioneve:

### 3. E- PETICIONI DREJTUAR KËSHILLIT BASHKIAK

#### 3.1 CFARË ËSHTË E- PETICIONI?



The screenshot shows the 'Regjistri i Peticioneve/Iniciativa Qytetare' website. The table below lists two petitions:

NR.	KODI I REGISTRIMIT	ÇESHTJA	GRUPI QË BËRI PETICIONIN	DATA E REGISTRIMIT NË PROTOKOLLIN E BASHKISË	DËRGIMI PËR MENDIM NË KOMISIONIN PËRKATES TË KËSHILLIT (NR. PROT TË BRENDSHËMË)	ËSHTË MBALJTOR DËGJESË PUBLIKE (DATA)	KALLJAR NË KËSHILL PËR SHQYRTIM (DATA)	MBËSHTETUR NGA KËSHILLI POJQJ	ZBATUAR KËRKESA E PETICIONIT NGA EKZEKUTIVI (DATA)	Kërkesë	
										RAPORTIMI NË KËSHILL DHE TEK GRUPIT INTERESIT (DATE)	PUBLIKIMI NË FAQEN E INTERNETIT TË BASHKISË (DATE)
1	11	Transferim stacioni	Shoqëria e autobusëve	23.02.2022	28.02.2022	Jo	31.03.2022	ne shqyrtim	ne shqyrtim	eshte rifoltuar	Jo
2	P1	Per asfaltimin e rruges te rrethit Pagan	Banoret	30.05.2022		Jo	ende jo	nuk eshte shqyrtuar	nuk eshte shqyrtuar ende	Jo	se shpejti
3											
4											
5											
6											
7											
8											

Peticioni është një kërkesë ose ankesë e shoqëruar me nënshkrime të një grupi banorësh apo organizatash drejtuar Këshillit Bashkiak, për ta nxitur atë të ndërmarrë një vendim apo veprim lidhur me shërbimet e ofruara nga Bashkia në drejtim të qytetarëve. Peticioni elektronik realizohet atëherë kur procesi i mbledhjes së nënshkrimeve të mbështetësve të petitionet realizohet në rrugë elektronike.

#### 3.2 KUSH KA TË DREJTË T'I PARAQESË KËSHILLIT BASHKIAK NJË PETICION?

Çdo qytetar që jeton, banon ose studion në territorin e bashkisë ose çdo organizatë që përfaqëson komunitetin ka të drejtë t'i drejtojë peticione Këshillit Bashkiak për çështje që lidhen me funksionet dhe kompetencat e bashkisë.

#### 3.3 KUSH E PËRFAQËSON PETICIONIN?

Çdo petition iniciohet nga minimalisht 3 parashtres votues në bashki mbi 18 vjeç ose një organizatë jofitiprurëse dhe nënshkruhet nga mbështetësit.

#### 3.4 CFARË DUHET TË PËRMBAJË NJË PETICION ELEKTRONIK?

- **Citimin** “Drejtuar Këshillit Bashkiak”
- **Bazën ligjore** “Neni 19 i Ligjit 139/2015”
- **Titullin** e peticionit
- **Peticioni fillon** “Ne të nënshkruarit, me këtë peticion, i kërkojmë K.B...”
- **Arsyet e paraqitjes së peticionit**
- **Të dhënat e parashtruesve të peticionit** “Emrat, ID-të, adresat dhe kontaktet”
- **Disclaimer-i** “Të dhënat personale do të përdoren vetëm për qëllimet e peticionit”
- **Afatin** “Data dhe ora e përfundimit të nënshkrimeve të peticionit.”

### **3.5 A MUND TË BASHKËLIDHEN DOKUMENTA TË TJERË SHOQËRUES NJË PETICIONI ELEKTRONIK?**

Peticionet mund të shoqërohen me dokumenta shtesë të cilët përbëjnë, fakte ose prova që ndihmojnë gjykimin objektiv në vendimamrren e Këshillit Bashkiak.

### **3.6 A NDIKON NUMRI I NËNSHKRIMEVE TË MBLEDHURA NË VENDIMARRJEN PËR NJË PETICION?**

Sigurisht që po. Peticionet kategorizohen bazuar në numrin e nënshkrimeve të mbledhura.

- **Peticionet me më pak se 100 nënshkrime të vlefshme**

Peticionin e administron Sekretari i Këshillit Bashkiak dhe ja përcjell Bashkisë. Bashkia përgjigjet brenda 20 ditëve, nga data e dërgimit të peticionit.

- **Peticionet me 100 deri në 1000 nënshkrime të vlefshme**
- Peticionin e administron Komisioni i peticioneve në Këshill dhe ky peticion i nënshtrohet debatit në Mbledhjen më të parë të Komisionit përkatës të përhershëm në Këshillin Bashkiak.
- **Peticione me mbi 1000 nënshkrime të vlefshme**



Peticionin e adminsitron Komisioni i peticioneve në Këshill dhe ky petition shqyrtohet në Mbledhen e Këshillit Bashkiak, jo më vonë se 60 ditë nga data e regjistrimit të petitionit.

### 3.7 CFARË VENDIMI MUND TË MARRË KËSHILLI BASHKIAK PËR NJË PETICION ELEKTRONIK?

Pas shqyrtimit të petitionit Këshilli mund të vendosë për

- Miratimin e kërkesën e petitionit, me ose pa ndryshim.
- Refuzimin e kërkesës së petitionit.
- Mbajtjen e një dëgjese publike në lidhje me çështjen e petitionit.
- Ndërmarrjen e një hulumtimi rreth çështjes së petitionit.

#### **Kujdes!**

- Nëse peticioni nuk përcakton qartë se kush janë parashtruesit, Këshilli nuk do ta shqyrtojë petitionin.
- Kërkesat që dërgohen të pa nënshkruara nuk i përcillen Kryetarit të Këshillit dhe nuk u kthehet përgjigje.
- Asnjë person nuk lejohet të nënshkruaj në emër të një personi tjetër ose të nënshkruaj një petition më shumë se një herë.
- Vlefshmëria e nënshkrimeve të një peticioni është 6 muaj, para se peticioni të regjistrohet në bashki.
- Këshilli ka të drejtë të verifikojë emrin, adresën dhe nënshkrimin e çdo personi që mbështet petitionin, nëse e konsideron të nevojshme.

Databasa e mbledhjes së nënshkrimeve duhet të përmbajë elementët e mëposhtëm:

Nr.	Emri	Mbiemri	ID	Njësia Administrative	Firma
1					

\*Afati i mbyljes së nënshkrimeve elektronike citohet në tekstin e petitionit.

### 3.8 RAST STUDIMOR PETICIONI ELEKTRONIK

Në vitin 2020 Qëndresa Qytetare së bashku me një grup të rinjsh, banorë të Qytetit Studenti organizuan peticionin drejtuar Këshillit Bashkiak Tiranë për kthimin mbrapsht të tarifave për kohën e karantinës të vendosur nga Komiteti Teknik i Ekspertëve. Në këtë periudhë studentet u larguan nga konviktet dhe drejtoria e Qendrës Rezidenciale Studentore nuk i ktheu mbrapsht parate që kishin paguar për një vit të plotë akademik.



Këshill i Qytetit Studenti përodri instrumentin QytetarIN të vënë në dispozicion nga Qëndresa Qytetare për të angazhuar studentët e ndarë në rrethe të ndryshme për t'iu drejtuar Këshillit Bashkiak Tiranë më një kërkesë të drejtpërdrejtë, për kthimin mbrapsht të shumës së paguar.

Pas nenshkrimit të peticionit nga 332 studentë dhe fushates mediatike në mbështetje të këtij peticioni, Bashkia vendosi t'u kthejë paratë studenteve, duke i kursyer xhepave të tyre rreth 1 milion euro në total.



Ky ishte ndër rastete e para të përdorimit të peticionit elektronik, gjatë një periudhe ku kontakti fizik me institucionet por edhe mes qytetarëve ishte i reduktuar. Por nënshkrimi elektronik nuk duhet parë vetëm si mundësi në raste të mungesës së kontaktit fizik, por edhe si instrument për të lehtësuar qasjen e qytetarëve në një peticion nga vendi i tyre i punës, apo banimit, vetëm duke klikuar dhe nënshkruar nëpërmjet pajisjes së tyre smart.

Në 17 qershor të vitit 2020, 50 banorë të lagjes ish-Poligrafik në Tiranë I drejtuan një peticion elektronik Bashkisë Tiranë me objekt algjimin e mbetjeve dhe rifillimin e punimeve të unazës së re e cila kishte krijuar një kaos urban në këtë zonë.

Pavarësisht dyshimit të banorëve në efektivitetin e këtij mjeti, vetëm dy javë pas depozitimit të peticionit në Këshillin Bashkiak Tiranë, në vend-depozitimin e mbetjeve u shfaqën fadromat

dhe makineritë të cilat pastruan zonën, firma e ndërtimit vijoi punimet dhe sot kjo është ndër zonat më të rehabilituara nga ana urbane.

Ky peticion elektronik u mundësua nëpërmjet platformës [www.qytetarin.com](http://www.qytetarin.com)

## 4. E- Iniciativa Qytetare drejtuar Këshillit Bashkiak

### 4.1 Cfarë është e-Iniciativa Qytetare?

E-Iniciativa Qytetare është një kërkesë ose propozim i një akti nënligjor, i shoqëruar me nënshkrime, që paraqitet për vendimmarrje në Këshillin Bashkiak, nga jo më pak se një për qind (1%) e banorëve të bashkisë.

### 4.2 Cfarë kërkohet nëpërmjet një Initiative Qytetare?

Nëpërmjet një Initiative Qytetare kërkohet miratimi i një akti normativ nënligjor, i një politike apo rregullore për çështje që janë brenda juridiksionit të Bashkisë dhe janë në kompetencën ligjore të Këshillit, miratimi i një rezolute, apo hedhja poshtë plotësisht apo pjesërisht e një dokumenti politike, rregullore apo akti tjetër normativ të miratuar më parë nga Këshilli Bashkiak.

### 4.3 Kush e përfaqëson Iniciativën Qytetare?

Çdo Iniciativë Qytetare iniciohet nga minimalisht 5 parashtrues, votues në bashki dhe mbi 18 vjeç ose një organizatë jofitiprurëse dhe më pas nënshkruhet nga mbështesit.

### 4.4 Cfarë duhet të përmbajë një Iniciativë Qytetare elektronike?

- **Citimin** "Drejtuar Këshillit Bashkiak"
- **Bazën ligjore** "Neni 19 i Ligjit 139/2015"
- **Titullin** e peticionit
- **Peticioni fillon** "Ne të nënshkruarit, me këtë peticion, i kërkojmë K.B..."
- **Arsyet e paraqitjes së peticionit**
- **Të dhënat e parashtruesve të peticionit** "Emrat, ID-të, adresat dhe kontaktet"

- **Disclaimer-i** “Të dhënat personale do të përdoren vetëm për qëllimet e peticionit”
- **Afatin** “Data dhe ora e përfundimit të nënshkrimeve të peticionit.”

#### **4.5A mund të bashkëlidhen dokumenta të tjerë shoqërues një iniciative qytetare elektronike?**

Iniciativat mund të shoqërohen me dokumenta shtesë të cilët përbëjnë, fakte ose prova që ndihmojnë gjykimin objektiv në vendimarrjen e Këshillit Bashkiak. Cdo iniciativë duhet të shoqërohet domosdoshmërisht me një relacion të detajuar i cili argumenton çështjet që duhet të shqyrtohen apo ndryshojnë dhe që ajnë objekt i kësaj iniciative elektronike.

#### **4.6 Cfarë vendimi mund të marrë Këshilli Bashkiak për një iniciativë qytetare elektronike?**

Pas shqyrtimit të iniciativës Këshilli Bashkiak mund të vendosë për

- Miratimin e iniciativës qytetare, me ose pa ndryshime.
- Refuzimin e iniciativës duke votuar kundër.
- Ndërmarrjen e një hulumtimi rreth çështjes së iniciativës dhe urdhërimin e bashkisë për të zbatuar urdhra dhe vendime që rrjedhin si pasojë e miratimit të iniciativës qytetare.
- Vendimi nuk merret në mbledhjen e Këshillit Bashkiak ku iniciativa prezantohet për herë të parë, përveç rastit kur, me vendim të shumicës së të gjithë Këshilltarëve vlerësohet se iniciativa trajton një rast emergjent.

#### **Kujdes!**

- Nëse iniciativa qytetare nuk përcakton qartë se kush janë parashtuesit, Këshilli nuk do ta shqyrtojë atë.
- Iniciativat që dërgohen të pa nënshkruara nuk i përcillen Kryetarit të Këshillit dhe nuk u kthehet përgjigje.
- Asnjë person nuk lejohet të nënshkruaj në emër të një personi tjetër ose të nënshkruajë më shumë se një herë.

- Vlefshmëria e nënshkrimeve të një iniciative qytetare është 6 muaj, para se peticioni të regjistrohet në bashki.
- Këshilli ka të drejtë të verifikojë emrin, adresën dhe nënshkrimin e çdo personi që mbështet peticionin, nëse e konsideron të nevojshme.

Databasa e mbledhjes së nënshkrimeve duhet të përmbajë elementët e mëposhtëm:

Nr.	Emri	Mbiemri	ID	Njësia Administrative	Firma
1					

\* Afati i mbylljes së nënshkrimeve elektronike citohet në tekstin e iniciativës.

#### 4.7 Si mund të nisësh një peticion ose iniciative qytetare elektronike nëpërmjet platformës [www.perqytetin.com](http://www.perqytetin.com)?

The screenshot shows the 'Nis një peticion ose Iniciativë' form. At the top, there is a navigation bar with the website name 'Per Qytetin' and a menu with items like 'PERI-QYTETIN', 'RRETH NESH', 'PETICIONI', 'INICIATIVA QYTETARE', 'KESHILLI BASHKIAK', and 'AKTIVITETE'. The main heading is 'Nis një peticion ose Iniciativë'. Below the heading, there is a short introductory text. The form itself consists of a large text area for the petition, a dropdown menu labeled 'Cfare kerkoni nga Keshilli Bashkiae?', and three input fields: 'Emër Mbiemër', 'Emër', and 'Email'.

1. Kliko [www.perqytetin.com](http://www.perqytetin.com)
2. Kliko "Nis një peticion ose iniciativë qytetare".
3. Plotësoni rubrikat e kërkuara duke përshkruar problematikën që doni të adresoni.
4. Kliko "dërgo" dhe shumë shpejt pas vlerësimit të peticionit, stafi i Qëndresës Qytetare iu vendos në dispozicion formularin elektronik në mënyrë që të nënshkruhet nga mbështetësit e peticionit.

## KËRKOJMË:

PAJISJEN E ÇDO STACIONI AUTOBUZI NË TIRANË, ME INFORMACION PËR LINJAT, ORARET DHE FREKUENCËN E LËVIZJES

## Emër Mbiemër \*

Emër

Mbiemër

## Jam banor i Njesisë Administrative:

Njësia Administrative Pezë

## Firma dixhitale \*



përdorni mausin në kompjuter ose gishtin/lapsin në telefonin tuaj për të hedhur firmën digjitale.

## Nr. juaj i telefonit

+383 067 212 3456

është opsionale

Dërgo

## 4.8 Si realizohet mbledhja e nënshkrimeve elektronike nëpërmjet platformës [www.perqytetin.com](http://www.perqytetin.com)?

1. Klikoi linkun e përcjellë nga parashtruesit e peticionit ose iniciativës qytetare elektronike.
2. Plotëso të dhënat e kërkuara.
3. Nenshkruaj nëpërmjet prekjes me gisht ose mouse në ekranin e tabletit apo celularit tuaj.
4. Ngarko/Dërgo nënshkrimin tënd.

## 4.9 Raste studimore iniciativa qytetare

### Iniciativë qytetare elektronike

Gjatë muajit dhjetor 2022 Qëndresa Qytetare në bashkëpunim me Kongresin Studentor, një organizim studentësh në nivel kombëtar, hartuan dhe ndërmorrën një iniciativë qytetare drejtuar Këshillit Bashkiak Tiranë për ndërtimin e katër mensave publike në katër godiant e konvikteve të studentëve, me qëllim reduktimin e kostove të ushqimit për studentët që studiojnë në kryeqytet.

Për këtë iniciativë u mbledhën në rrugë elektronikë 6620 nënshkrime, të cialt u depozituan në Këshillin Bashkiak, çështje e cila pritet të shqyrtohet prej këtij këshilli sipas rregullores së iniciativave dhe peticioneve dhe për zbatim të nenit 20 të ligjit për vetqeverisjen vendore. Depozitimi i kësaj iniciative është rasti i parë i ndërmarrjes së kësaj procedure administrative në funksion të një komuniteti sic është ai i studentëve.

*Firmos peticionin për* **NDËRTIMIN E 4 MENSAVE PUBLIKE**

TË CILAT DUHET TË OFROJNË USHQIM ME KOSTO TË REDUKTUAR PËR ÇDO STUDENT TË PAJISUR ME KARTËN E STUDENTIT.

Qyteti Studenti UBT Mjekësia Konviklet e inshinise

## Iniciativë Qytetare fizike



Qendresa Qytetare në bashkepunim me Ogerta Ujkashi kanë ndërmarrë iniciativën qytetare fizike të parë në Republikën e Shqipërisë bazuar në ligjin 139/2015 për Vetqeverisjen Vendore. Iniciativa është ndërmarrë në vitin 2018 - 2019 nën moton "Pa Zhurmë" ku kërkohej miratimi i planit lokal të veprimit për Zhurmat në Bashkinë Tirane, plan i cili u miratua në vitin 2021.

Në janar të 2021 Bashkia vendosi të hapë tenderin për hartimin e Planit Vendor për Zhurmat, me fond limit 2, 256, 000 lekë, dhe në tetor të 2021,

u hartua drafti i Planit të Veprimit për Kontrollin e Zhurmave të kërkuar aq fort nga shoqëria civile dhe ekspertët mjedisorë. Ky proces u pasua me dy dëgjesa publike me banorë dhe palët e interesuara, përfshirë Ministrinë e Mjedisit, duke filluar nga data nga 1 Nëntori 2021, ku u ftuan edhe përfaqësues të shoqërisë civile.

Kjo histori ka dy suksese, një institucional dhe një që lidhet me planin e kontrollit të zhurmave. Për herë të parë pas miratimit të ligjit për vetqeverisjen vendore, hartohet dhe nënshkruhet nga banorët e Tiranës një iniciativë qytetare dhe i drejtohet Këshillit Bashkiak. Megjithëse koha ka qenë e gjatë, u arrit që kjo iniciativë të përkthehet në një produkt nga Bashkia dhe Këshilli Bashkiak, në një plan rregullues për zhurmat në kryeqytet.



Ky manual u ndërtua në kuadër të projektit “Për Qytetin” me mbështetjen e LevizAlbania, një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC.

Mendimet dhe opinionet e shprehura në të i përkasin autorëve realizues dhe nuk përkojnë domosdoshmërisht me qëndrimet e donatorit.

## Për Qytetin

